



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

PËR VEPRIMTARINË

E

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN
PËR VITIN 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN

Nr. ____ Prot,

Datë 18/03/2025

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

Dokumenti “Raporti vjetor i performancës” i Gjykatës përfaqëson në mënyrë të përmbledhur analizën e punës së kryer dhe performancën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan gjatë vitit kalendarik 2024, parashtrohet njëkohësisht problematikat e konstatuara gjatë këtij viti përse i takon funksionimit të institucionit në tërësi si dhe sfidat për të ardhmen.



Tema të analizuara:

I. Hyrje

II. Veprimtaria Gjyqësore

1. Ngarkesa dhe lloji i çështjeve gjyqësore.
2. Tendenca e ngarkesës me çështje.
3. Likujdimi/përfundimi i çështjeve.
 - a. Çështjet penale themeli
 - b. Kërkesa penale-administrative
 - c. Kërkesa penale në seancë paraprake
 - d. Çështjet civile
4. Ngarkesa me çështje për gjyqtar.
 - a. Performanca e gjyqtarëve
 - b. Delegimet e gjyqtarëve
5. Shpejtësia në gjykim.
6. Heqjet dorë nga gjykimi i çështjeve.
7. Përjashtimet e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve.

III. Menaxhimi i Lëvizjes së Çështjeve Gjyqësore

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.
2. Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

IV. Menaxhimi administrativ i gjykatës

1. Organika dhe burimet njerëzore.
2. Këshilli i gjykatës dhe titullari
3. Burimet materiale
4. Teknologjia e informacionit.
 - a. Sistemi i regjistrimit audio-video të seancave gjyqësore
 - b. Programi i transparencës
5. Ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.
6. Akses, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.
7. Çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.
8. Administrimi i fondeve publike
9. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

I. HYRJE

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan aktualisht ushtrojnë detyrën 13 gjyqtarë, nga 18 gjyqtarë që ka në organikë kjo gjykatë. Gjatë vitit 2024 ka patur lëvizje të shpeshta gjyqtarësh. Kështu, në muajin prill u transferua nga gjykata e Dibrës një gjyqtare, por në fund të muajit maj, një gjyqtare e gjykatës sonë u komandua në Gjykatën e Lartë. Në muajin shtator dhe tetor ushtroi detyrën e gjyqtarit një gjyqtare që është e komanduar në këtë gjykatë, por që më pas mori lejen e barrë-lindjes. Po kështu, në 1 tetor një gjyqtare që ushtronte edhe detyrën e Zv/kryetarit, u komandua në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Po në muajin tetor, me vendim të KLGJ, filluan detyrën në gjykatën tonë dy magjistratë të rinj dhe në fund të muajit dhjetor u rikthye në detyrë një gjyqtare, pas përfundimit të lejes së barrë-lindjes.

Në Gjykatë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, gjatë vitit 2024, kanë funksionuar dy seksionet; penal dhe civil. Levizjet e disa gjyqtarëve nga apo drejt gjykatave të tjera, kanë sjellë edhe ndryshime në përbërjen e këtyre seksioneve.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në mbështetje të nenit 28§2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar me ligjin nr.37/2017, dhe Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Vendim të Këshillit të Gjykatës, aktualisht janë të caktuar si gjyqtarë të specializuar për çështjet penale me të mitur, gjyqtar Elis Dine, gjyqtare Suela Lika dhe gjyqtar Artur Prenga, duke përfshirë këtu gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

II. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. NGARKESA DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë paraqitur për shqyrtim **në total 11216 çështje** (të natyrës penale, penale-administrative, civile dhe familjare). Në numrin e çështjeve për shqyrtim përfshihen **4333** çështjet e mbartura nga viti 2023 dhe **6883** çështje të regjistruara të reja në vitin 2024.

Nga totali i çështjeve për shqyrtim, për **5970** çështje ka përfunduar gjykimi në vitin 2024, ndërsa **5246** çështje kanë mbetur papërfunduar dhe janë mbartur për gjykim në vitin 2025, sipas tabelës së mëposhtme

Tabela.1

Volumi i Çështjeve viti 2024	Numri
Çështje të gjykuara	5970
Çështje të mbartura në 2025	5246
Totali i çështjeve për shqyrtim	11216
Çështje të regjistruara të reja në 2024	6883

Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se:

1. Në lëndë penale, ka përfunduar gjykimi për një total prej **3076** çështje. Në këtë numër përfshihen çështje penale themeli, penale të posaçme, kërkesa penale-administrative, kërkesa penale gjatë hetimeve paraprake, në seancë paraprake dhe kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit.
2. Në lëndë civile dhe familjare ka përfunduar gjykimi për **2894** çështje.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, rezulton se ngarkesa me **11216** çështje gjyqësore për gjykim ishte ndër më të lartat që ka patur kjo gjykatë. Në këtë aspekt ka ndikuar padyshim edhe mbartja e një numri të madh çështjesh nga vitet e kaluara.

Numri i çështjeve penale është i lartë edhe për faktin që Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbulon kërkesat e të dënuarve në IEVP-Peqin dhe IEVP-Kosovë, Lushnje. Po ashtu, përfshihen edhe kërkesat e të dënuarve në paraburgimin e Elbasanit.


2. TENDENCA E NGARKESËS ME ÇËSHTJE.

Për të parë tendencën e ngarkesës le ti referohemi tabelës të çështjeve për 5 vitet e fundit, duke bërë edhe krahasimet përkatëse:

Tabela.2

	Çështje të regjistruara për gjykim	Çështje të gjykuara	Çështje të mbartura
Viti 2024	11216	5970	5246
Viti 2023	8634	4301	4333
Viti 2022	9953	6570	3383
Viti 2021	9258	6664	2594
Viti 2020	8924	6722	2202


**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**



Raporti i numrit të çështjeve rregjistruara në total (përfshirë të mbartura nga viti paraardhës) në 5 vitet e fundit:

Tabela.3


Çështje të rregjistruara në total (penale dhe civile)				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
8924	9258	9953	8634	11216



Numri i çështjeve të regjistruara të reja (duke mos përfshirë të mbarturat nga viti i mëparshëm) në 5 vitet e fundit:

Tabela.4


Çështje të regjistruara të reja (penale dhe civile)				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
7683	7056	7359	5251	6883



Numri i çështjeve të gjykuara në vitet e fundit:

Tabela.5

Çështje të gjykuara penale dhe civile				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
6722	6664	6570	4301	5970



Të dhënat statistikore për tendencën e ngarkesës me çështje për vitet e fundit tregojnë se në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, ka një rritje të theksuar, rreth 40%,

të çështjeve të gjykuara. Në këtë drejtim, ka ndikuar padyshim shtimi i numrit të gjyqtarëve, duke patur një koeficient 11 të numrit mesatar të gjyqtarëve për gjatë viti 2024. Gjithsesi, largimet dhe ardhja e disa gjyqtarëve, si dhe rishpërndarjet e dosjeve, por edhe mungesat e gjata në punë për shkak të gjendjes të rënduar shëndetsore të një gjyqtari, kanë ndikuar negativisht që numri i çështjeve të gjykuara gjatë 2024 të ishte edhe më i madh.


Pavarësisht rritjes me 40% të numrit të çështjeve të gjykuara në total, ky vit paraqitet me numër të vogël të çështjeve të gjykuara për gjyqtar, krahasuar me një vit më parë. **Por në këtë drejtim, është punuar më shumë për të zgjidhur dosjet e mbartura prej vitesh. Pra kemi një likuidim të back-log (mbartje) të viteve të mëparshme.**

3. LIKUJDIMI/PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE.

Numri i çështjeve të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës, në pesë vitet e fundit:

Tabela.6

Çështje të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës (penale dhe civile)				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
2202	2594	3383	4333	5246



Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se në fund të vitit 2024, numri i çështjeve të mbartura është rritur me rreth 21% krahasuar me vitin paraardhës. Kjo rritje, një vit më parë ishte 28%, pra ka një përmirësim të lehtë në këtë drejtim.

Rritja e numrit të çështjeve të mbartura në fund të vitit 2024 lidhet me faktin që këtë vit janë regjistruar 31% më shumë çështje reja se një vit më parë. Edhe rishpërndarjet e çështjeve pas largimeve të gjyqtarëve, rrisin kohën e zgjidhjes duke rritur njëkohësisht edhe stokun për vitin pasardhës. Në mbledhjet e gjyqtarëve të

muajve të fundit të vitit 2024 u morën masa për efidentimin e çështjeve të vjetra dhe dhënien përparësi për zgjidhje të tyre nga grupi i gjyqtarëve.

Në tabelën vijuese, pasqyrohen të dhënat e numrit të çështjeve penale dhe civile, mbetur pa përfunduar në fund të vitit 2024:

Tabela.7

Lloji i çështjeve të mbartura	Numri i çështjeve të pa përfunduara në fund të vitit 2024
Civile	2771
Penale	2475

Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*”, (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjestimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje), në vitin 2024 është **86.73%**, pra më e lartë se e vitit 2023, ku kjo vlerë ishte përkatësisht **81.90%**. Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon nëse gjykata ka qënë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim dhe për rrjedhim nëse edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm janë zgjidhur. Norma e likuidimit mbi 100% është tregues pozitiv për likuidimin e çështjeve si Gjykatë. Vlera e *Clearance rate* për vitin 2024 sigurisht që në shikim të parë, nuk duket pozitive, por rritja me gati **5 %** e saj, tregon që gjykata është duke e përmirësuar këtë parametër dhe është në rrugë të mbarë. Nga ana tjetër, ky parametër dëshmon edhe njëherë që plotësimi sa me shpejt i organikës edhe me 5 gjyqtarë të tjerë është një domosdoshmëri për ecurinë normale të punës në këtë gjykatë.

Në fakt, në dallim nga viti 2023, konstatohet që norma e likuidimit të çështjeve penale është më e ulët se norma e likuidimit të çështjeve civile, përkatësisht **84.56 %** dhe **89.21 %**. E gjithë kjo, shpjegohet me faktin që në dallim me vitin 2023, ku grupi prej 3-4 gjyqtarësh të mbetur, në mënyrë që të respektonte afatet ligjore, u mundua të gjykonte kryesisht çështjet penale, për shkak se në vitin 2023 nuk kishte mundësi reale për formimin e seksioneve. Këtë vit ndarja në seksione, ka bërë që tu jepet rëndësia e duhur zgjidhjes të çështjeve civile.

- Për të gjitha çështjet e shqyrtuara në gjykatë në vitin 2024, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **86.73 %**.

$$\text{Clearance rate}_{total} = \frac{5970 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara 2024]}}{6883 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100\% = 86.73 \%$$

- Për çështjet e natyrës **penale**, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është **84.56%**

$$\text{Clearance rate}_{\text{penale}} = \frac{3101 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara 2024]}}{2971 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100 \% = 84.56\%$$

- Për çështjet e natyrës **civile**, norma e përfundimit/likuidimit të çështjeve “Clearance rate” është **89.21 %**

$$\text{Clearance rate}_{\text{civile}} = \frac{2869 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara 2024]}}{3216 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2024]}} \times 100\% = 89.21 \%$$

a. Çështje penale themeli.

Nga **632** çështje të gjykuara të natyrës penale themeli, rezulton se **619** prej tyre janë gjykuar me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ndërsa **13** çështje penale janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë.

Pas muajit Gusht të vitit 2017, pra edhe në këto vite në vazhdim, rezulton një numër i vogël çështjesh të gjykuara me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë, për shkak të ndryshimit në nenin 13 të K.Pr.Penale, që lidhet me rritjen e maksimumit të dënimit penal nga 7 vjet në 10 vjet, për çështjet që gjykohen me tre gjyqtarë.


Tabela.8

Nr.	Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2020	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023	Numri i çështjeve në vitin 2024
1	Penale themeli	739	872	714	517	632
2	Kërkesa penale, kërkesa administrative-penale etj.	3576	2334	2810	2178	2469

Në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës në çështjet e natyrës penale themeli, rezulton se gjatë vitit 2024, janë dënuar në total **776** persona, **32** gra dhe **744** burra, nga të cilët **18** të mitur në konflikt me ligjin (meshkuj). Për **13** persona gjykata ka dhënë vendim pafajësie, për **87** persona gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale.

Tabela.9

Të dënuar	Numri personave në vitin 2020	Numri personave në vitin 2021	Numri personave në vitin 2022	Numri personave në vitin 2023	Numri personave në vitin 2024
Burra (adult)	727	851	804	550	726
Gra	37	67	24	26	32
I mitur në konflikt me ligjin (meshkuj)	6	10	13	6	18
Totali të dënuar	770	928	841	582	776
Totali pafajësi	25	9	12	3	13
Pushimin e çështjes	36	62	36	19	87



Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë gjykuar 18 të mitur në konflikt me ligjin. Në mbështetje të nenit 28§2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të miratuar me ligjin nr.37/2017, në zbatim të Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e gjyqtarëve, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale” janë caktuar gjyqtarët e specializuar për çështjet penale me të mitur, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Në tabelën që pason po paraqesim të dhëna statistikore për numrin e çështjeve të gjykuara në bazë të figurës së veprës penale:

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

Tabela.10

Nr.	Figura e veprës penale	Neni i K.Penal	Numri i çështjeve të gjykuara				
			Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
1	Vrasjes me dashje	Neni 76 i K.Penal	1	0	2	3	3
2	Vrasjes me paramendim	Neni 78/1 K.Penal	1	1	1	0	2
3	Vrasje ne rrethana cilësuese	Nenet 79/a dhe 79/dh të K.Penal	0	0	0	3	4
4	Plagosje e rëndë me dashje	Neni 88 i K.Penal	2	3	2	1	1
5	Vjedhje	Neni 134/1,2 i K.Penal	29	61	35	28	45
6	Vjedhje me dhunë	Neni 139 i K.Penal	1	1	1	1	1
7	Falsifikimit të dokumenteve	Neni 186 K.Penal	3	2	4	5	4
8	Armëmbajtje pa leje	Neni 278/2,4,5 i K.Penal	9	8	8	7	9
9	Shpërdorimi i detyrës	Neni 248 i K.Penal	7	0	1	5	1
10	Prodhimit dhe shitjes se narkotikëve	Neni 283/1, 2 i K.Penal	13	24	16	28	90
11	Kultivimi i bimëve narkotike	Neni 284/1, 2 i K.Penal	3	5	6	6	3
12	Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor	Neni 290 i K.Penal	18	28	33	26	18
13	Futja ose mbajtjes së sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim	Neni 324/a/1 i K.Penal	19	30	14	8	5
14	Kanosje	Neni 84 i K.Penal	0	2	0	0	0
15	Plagosjes së lehtë me dashje	Neni neni 89 i K.Penal	25	23	15	13	12
16	Përndjekjes	Neni 121/a i K.Penal	1	0	1	1	3
17	Dhunë në familje	Neni 130/a i K.Penal	51	46	73	71	73
18	Vjedhje e energjisë elektrike	Neni 137/1,2 i K.Penal	27	16	11	4	2
20	Fshehje e të ardhurave	Neni 180 i K.Penal	1	6	5	1	5
21	Ndërtim i paligjshëm	Neni 199 i K.Penal	135	119	64	45	20
22	Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt	Neni 291 i K.Penal	231	223	229	146	232
23	Mashtrimi	Neni 143 i Kodit Penal	5	7	3	4	4

Nisur nga të dhënat e mësipërme rezulton se kriminaliteti në territorin ku ushtron veprimtarinë juridiksionale Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri të ulët. Veprat penale më të përhapura në vitin 2024 janë veprat penale të **“Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt”** (Neni 291 i K.Penal), **“Dhuna në familje”** (Neni 130/a), **“Vjedhja”** (Neni 134 i K.Penal), **“Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”** (Neni 290 i K.Penal), **“Ndërtim i paligjshëm”** (Neni 199/a i K.Penal), **“Vjedhja e energjisë elektrike apo e impulseve telefoni”** (Neni 137 i K.Penal), veprat penale në fushën e narkotikëve si dhe **“Armëmbajtje pa leje”**.

Në ndryshim nga viti i kaluar, vërehet që vepra penale **“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”**, këtë vit, i është rikthyer në vlerave të viteve të mëparshme. Për rrjedhim ka nevojë për më shumë ndërgjegjësim dhe parandalim të kësaj vepre penale nga institucionet përgjegjëse.

Shqetesuese gjatë vitit 2024, vazhdon të përbëjë vepra penale e **“Dhunës në familje”**, duke i klasifikuar tre vitet e fundit, si vitet me treguesin më negativ për sa i përket kësaj vepre penale, në 12 vitet e fundit. Ky tregues është domethënës i problematikës dhe fenomenit të dhunës në familje. Vërehet se viktimat e dhunës në familje në një numër të konsiderueshëm rastesh kërkojnë urdhër mbrojtje dhe pajisen me urdhër mbrojtje nga gjykata.

Pas një qëndrueshmërie që ka patur prej disa vitesh vepra penale e **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, duke ju referuar numrit 90 persona të dënuar për këtë vepër, vërehet një rritje me 3 herë krahasuar me vitet e mëparshme, duke bërë kështu këtë vepër, si vepra penale që ka rritjen më të madhe këtë vit. Ndërsa vepra **“Kultivimi i bimëve narkotike”** është në vlera të qëndrueshme me 4 vitet e fundit.

Edhe këtë vit, vazhdon rënia e konsiderueshme (për të shtatin vit rradhazi) e çështjeve që kanë bëjnë me veprën penale të **“Vjedhjes së energjisë elektrike”**. Ne besojmë, që ky fakt, ka të bëjë edhe me ndërgjegjësimin e shtetasve, dhe si rezultat këtë vit kemi patur vetëm 2 persona të dënuar për këtë vepër.

Të njëjtin trend ka ndjekur edhe vepra penale **“Ndërtim i paligjshëm”** (Neni 199/a i K.Penal), që ka një rënie prej 55% krahasuar me 2023 dhe kjo rënie vazhdon për të pestin vit rradhazi.

Ndërsa rastet e veprave penale me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore janë të pakta dhe në to mbizotëron vepra penale e **“Armëmbajtje pa leje”**, me numër të qëndrueshëm çështjesh prej 3-4 vitesh, megjithëse ka një rritje të lehtë gjatë 2024.

Në tabelën 11 pasqyrohen llojet e dënimeve të dhëna nga gjykata:

Tabela.11

Dënimi	Numri i personave të dënuar në vitin 2021	Numri i personave të dënuar në vitin 2022	Numri i personave të dënuar në vitin 2023	Numri i personave të dënuar në vitin 2024
Me gjobë	87	44	36	26
Burgim deri në dy vjet.	218	378	371	355
Burgim nga 2 deri ne 5 vjet.	31	102	64	107
Burgim nga 5 deri ne 10 vjet.	14	6	10	12
Burgim nga 10 deri ne 25 vjet.	2	4	4	5
Burgim nga 25 deri ne 35 vjet	0	0	1	0
Burgim i përjetshëm	0	0	2	1
Aplikimi i nenit 59	499	219	81	143
Aplikimi i nenit 59/a	0	6	0	
Aplikimi i nenit 63	76	34	13	27
Totali	928	793	582	676

Rezulton që numri i personave të dënuar gjatë 2024 është **676** dhe krahasuar me vitin 2023, kemi **94** më shumë të dënuar. Por kjo ka të bëjë edhe me numrin më të vogël të çështjeve të gjykuara gjatë 2023. Gjatë vitit 2024 rezulton të jetë i dënuar vetëm 1 person me burgim të përjetshëm. Dënimi më i aplikuar nga gjykata është dënimi me **burgim deri në 2 vjet**, i cili referuar të dhënave statistikore për figurat e veprave penale, përputhet me rrezikshmërinë e ulët të veprave penale më të përhapura. Në vitin 2024 numri i personave të dënuar me gjobë është në ulje krahasuar me tre vitet e mëparshëm. Por, këtë vit, në vlerë absolute më të lartë se vitin e kaluar, bie në sy edhe aplikimi i nenit **59** dhe **63** i K.Penal, si dënime alternative, duke pezulluar dënimin me burgim dhe vënien në provë, i ndjekur nga kryerja e një pune me interes publik pa shpërblim.

Nga analiza e të dhënave të vitit 2024 rezulton se numri i çështjeve që janë shqyrtuar me gjykim të shkurtuar është i konsiderueshëm, ndërsa gjykimi i drejtpërdrejtë është aplikuar pak. Me ndryshimet me ligjin nr.35/2017 të K.Pr.Penale janë shtuar edhe lloje të tjera të gjykrimeve të posaçme si Urdhëri penal dhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë. Por, edhe numri i këtyre gjykrimeve është i ulët.

b. Kërkesat administrative-penale.

Gjatë vitit 2024 janë gjykuar **2469** çështje të natyrës kërkesa penale dhe kërkesa administrative-penale, ku përfshihen kërkesat në fazën e hetimeve paraprake, si vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, lejim përgjimi etj, kërkesa në fazën e ekzekutimit të dënimit, si ulje dënimi, lirim para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit, aplikim të dënimeve alternative, kërkesa për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë si kërkesa për njohje të vendimeve të gjykatave të huaja, kërkesë për ekstradim etj. Krahasuar me 2023, janë gjykuar rreth **300** më shumë çështje të kësaj natyre.

Janë shqyrtuar **920** masa sigurimi, ndër to **480** kërkesa të tjera, ku përfshihen edhe lejim apo vleftësim të përgjimit.

Tabela.12

Lloji i masës sigurimit	Numri i personave		
	në vitin 2022	në vitin 2023	në vitin 2024
Arrest në burg	236	198	171
Arrest në shtëpi	24	33	87
Detyrim për paraqitje	273	213	177
Arrest në burg në mungesë	1	0	0
Mjekim i detyruar	6	1	3
Rivlerësim i masave të sigurimit	0	0	0
Garancia pasurore	1	2	2
Njohja e vendimeve penale të huaja	1	0	0
Kërkesa të tjera penale	127	366	480
Totali	669	813	920

Nga treguesit e mësipërm rezulton se masat e sigurimit më të aplikuara nga gjykata janë ato “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” dhe “arrest në burg”. Në disa raste, masat e sigurimit personal të karakterit shtrëngues janë caktuar së bashku me masa të tjera shtrënguese si “Ndalim i daljes jashtë shtetit” dhe masa ndaluese si “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”.

Nga të dhënat për vitin 2024, krahasuar me dy vitet parardhëse, vërehet një shtim e aplikimit të masave të sigurimit personal.

c. Kërkesat penale në seancën paraprake.

Pas ndryshimeve, me ligjin nr.35/2017 në K.Pr.Penale, numri i kërkesave të seancës paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesa për pushimin e çështjes penale për krime, vazhdon të jetë relativisht i lartë, por gjithsesi më i ulët, krahasuar me dy vitet paraardhës.

Në vitin 2024 janë regjistruar **1864** kërkesa të seancës paraprake të reja, ndërkohë janë mbartur **1368** nga viti 2023. Ka përfunduar gjykimi për **1065** kërkesa, dhe janë aktualisht në gjykim **2167**, me tregues sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela.13

MËNYRA E PËRFUNDIMIT					
Pranuar Pushumi	Kaluar për gjykim	Kthim për plotësim hetimesh (penale)	Vendosur Moskompete nca	Të tjera	Përfunduar
296	690	22	2	55	1065

d. Çështjet civile:

Gjatë vitit 2024, janë gjykuar gjithsej **2869** çështje civile, nga të cilat **1431** civile themeli.

Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, në vitin 2024 janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me një gjyqtar **2857** çështje civile dhe me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë janë gjykuar vetëm **12** çështje civile. Numrit të çështjeve që gjykohen me trup gjykues me tre gjyqtarë krahasuar me vitin 2023 është në rritje.

Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet një numër prej **623** çështje civile të pushuara gjatë vitit 2024. Duke u krahasuar me **305** çështje civile të pushuara në vitin 2023, duket një rritje me gati dy herë në vlerë absolute, por përqindja që ato zënë në çështjet e gjykuara është vetëm 3 % më e madhe.

Më poshtë vijon tabela me përqindjet që zënë çështjet e pushuara në katër vitet e fundit:

Viti	2021	2022	2023	2024
Përqindja	21%	13%	18%	21%

Shkaku i pushimit të çështjeve civile lidhet kryesisht me mosndërgjegjësimin për plotësimin e elementëve të padisë, mosparaqitja e paditësit/kërkuesit pa shkaqe të arsyeshme dhe tërheqja nga gjykimi i padisë/kërkesës. Rastet e padisë që nuk mund të ngrihet janë të pakta.

Në zbatim edhe të vendimit të KLGJ-së Nr. 554 dt. 29.12.2022 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore” çështjet e pushuara dhe çështjet për të cilat është vendosur “Kthim Aktesh”, kur janë riparaqitur për shqyrtim në gjykatë, i kanë kaluar automatikisht të njëjtit gjyqtar që i ka pushuar më parë. **Kjo ka ardhur edhe si rezultat i gjetjave të kontrollit tematik të Inspektorit Të Lartë të Drejtësisë, me rekomandimet që ka lënë për Gjykatën Elbasan.**

Disa nga llojet më të përhapura të çështjeve të natyrës civile të gjykuara gjatë vitit 2024, krahasuar edhe të dhënat e tre viteve të tjera, paraqiten si vijon:

Tabela.14

Lloji i çështjes	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023	Numri i çështjeve në vitin 2024
Kthim sendi	25	8	10	11
Padi pronësie	36	19	15	45
Padi për shkaktimin e dëmit	40	24	10	34
Pjestim sendi	14	17	10	11
Kundërshtim të veprimeve përmbarimore	15	26	20	56
Konflikte pune etj	48	20	9	30
Familjare	798	770	701	1103
Urdhëra mbrojtje	177	223	208	214
Urdhëra të menjëhershëm të mbrojtjes	36	28	16	31



Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se edhe për vitin 2024 ngarkesa më e lartë është me çështje familjare dhe pas tyre renditen kërkesat për urdhër mbrojtje. Çështjet familjare të gjykuara gjatë 2024 janë **1103**, ku mbizotërojnë paditë

për zgjidhje martese (776 të tilla). Paditë për zgjidhje martese të përfunduara këtë vit janë gati 80% më shumë se një vit më parë. Kjo tregon për përmirësimin këtë vit të efikasitetit në gjykim të çështjeve civile në përgjithësi dhe familjareve në veçanti, për shkak edhe të sensibilitetit që ka trupa gjyqësore për zgjidhjen e kësaj kategorie çështjesh, me efekt financiar dhe shoqëror.

Ky rezultat i kënaqshëm i dedikohet punës së bërë nga seksioni civil, duke qënë se edhe numri i gjyqtarëve në këtë seksion është më i lartë.

Përsa i përket urdhërave të mbrojtjes, numri i përgjithshëm i tyre ka një rritje këtë vit, me 245 kërkesa, kur në 2023 kishim përkatësisht 224.

Rritje me gati dy herë kanë patur edhe kërkesat për urdhër të menjëhershëm mbrojtje. Këtë vit kemi patur 31 kërkesa të tilla, nga 16 që kemi patur një vit më parë.

Pothuajse të gjitha kërkesat për urdhër mbrojtje janë përcjellë/paraqitur nga ana e Komisariateve të Policisë në bazë të formularëve të plotësuar nga kërkuesit.

Tabela.15

Lloji i kërkesave për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes	Numri	Pranuar	Pushuar	Refuzuar
Urdhër i zakonshëm mbrojtjeje	214	133	43	38
Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje	31	26	3	2
Totali	245	159	46	40

Nga analiza e të dhënave vërehet se numri i rasteve të refuzimit është më i vogël në raport me numrin e rasteve kur gjykata ka pranuar lëshimin e urdhërit të mbrojtjes.

Shkaqet e refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes lidhen me faktin se nuk provohet ekzistenca dhunës ose pala paditëse nuk legjitimohet për të kërkuar lëshimin e urdhërit të mbrojtjes, për shkak se nuk cilësohet nga ligji si pjestarë familjeje, por konstatohen dhe raste të pushimit të gjyqimit. Shkaqet e pushimit janë mosparaqitja e viktimës së dhunës në familje në seancë gjyqësore pa shkaqe.

Por, praktika mbizotëruese është ajo e shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje edhe në rast të mosparaqitjes në seancë apo tërheqjes së viktimës së dhunës në familje, pasi lejohet kjo gjë me ndryshmet e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Kërkesat civile (çështje civile pa palë kundërshtare), disa lloje:

Tabela.16

Lloji kërkesave civile pa palë kundërshtare	Numri i çështjeve në vitin 2021	Numri i çështjeve në vitin 2022	Numri i çështjeve në vitin 2023	Numri i çështjeve në vitin 2024
Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit	2006	1862	610	1150
Vërtetim fakti i vjetërsisë në punë	26	11	13	22
Lëshim autorizimi për të miturin	26	9	18	33

Nga analiza e të dhënave rezulton se ngarkesa më e lartë është me kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ku mbizotërojnë kërkesat për tituj ekzekutivë si faturat e energjisë elektrike, fatura të konsumit të ujit dhe kontratat e kredisë bankare. Ky numër është 2 herë më i lartë se një vit më parë, por kjo ka të bëjë, edhe me rritjen e numrit të të gjyqtarëve këtë vit dhe funksionimit normal të seksionit civil.

Rritje kanë patur edhe numri i kërkesave për vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë nga ana e shtetasve që kërkojnë përfitimin e të drejtës për pension, për shkak të mungesës së dokumentacionit të kohës, si dhe Lëshim autorizimi për të miturin, përkatësisht 22 dhe 33 të tilla.

4. NGARKESA ME ÇËSHTJE PËR GJYQTAR.

Aktualisht organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk është e plotësuar me numrin 18 gjyqtarë. Pavarësisht se viti 2024 filloi me 11 gjyqtarë efektivë, ky vit është karakterizuar nga largimet apo ardhjet e disa gjyqtarëve. Ky fenomen ka ndikuar ndjeshëm në rendimentin e gjykimeve të çështjeve, pasi vazhdimisht nëpërmjet shortit, gjyqtarëve të mbetur në detyrë, krahas shortit ditor të çështjeve të reja të regjistruara, u janë ndarë çështjet e gjyqtarëve të dorëhequr apo të transferuar në gjykata të tjera. Në prill 2024, një gjyqtar u transferua ne gjykatën tonë nga gjykata e Dibrës, por në muajin maj, një gjyqtare u komandua në Gjykatën e Lartë dhe një gjyqtar tjetër largohet me dorëheqje. Në muajin Shtator 2024 komandohet në Gjykatën Elbasan një gjyqtare, e cila në muajin tetor largohet pasi mori lejen e barrë-lindjes. Në datën 1 tetor, komandohet në gjykatën e Tiranës një gjyqtare që kryente edhe detyrën e Zv/Kryetares në Gjykatën Elbasan. Në fund të vitit 2024 u rikthye në detyrë pas lejes se barrë-lindjes, edhe një gjyqtare. Aktualisht numri i stafit magistrat në gjykatë është 12 gjyqtarë, të cilët operojnë në dy seksionet.

Megjithatë është domosdoshmëri plotësimi i organikës së gjykatës me 18 gjyqtarë, për shkak të ngarkesës të lartë të çështjeve që ka për gjykim secili gjyqtar dhe pasi aktualisht gjykatës i mungojnë 5 gjyqtarë, përveç gjyqtares Emirjana Dimo që është me lejen e barrë-lindjes.

Të dhënat statistikore të vitit 2024, për çdo gjyqtari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan sipas numrit të çështjeve të gjykuara, janë:


Tabela.17

Nr.	Gjyqtar:	Numri i çështjeve të përfunduara viti 2024
1	MATILDA FETAU	300
2	IDUSH MALIQI	201
3	ELIS DINE	566
4	ARTUR PRENGA	642
5	YRFET SHKRELI	607
6	THOMAI DHA ROCA	236
7	Ardit KUKA	804

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

8	GJERGJI BACI	678
9	AURORA ALIMADHI	567
10	INA YZELLARI	550
11	OLTA CENAJ	329
12	SUELA LIKA	387
13	EMIRJANA DIMO	10
14	BOIKEN BENDO	46
15	XHULIO DOKU	47

Në vijim është paraqitja grafike e shpërndarjes së numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2024.



Bie në sy numri i lartë i çështjeve të përfunduara nga gjyqtarët **Ardit Kuka** dhe **Gjergji Baçi** për seksionin civil dhe **Artur Prenga** dhe **Yrfet Shkreli** për seksionin penal. Gjithsesi, të gjithë gjyqtarët, kanë kaluar normën e një gjyqtari për periudhën që kanë gjykuar në këtë gjykatë, pasi nga analiza e të dhënave evidentohet se ngarkesa e gjyqtarëve me çështje plotëson parametrat e vendosura në vendimin e KLGJ-së për kriteret matëse të vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve, dhe madje e tejkalon dukshëm atë ngarkesë, shifër e cila është 429 çështje/gjyqtar.(120-200 çështje themeli dhe 280-300 çështje administrative civile ose penale)

Bazuar në një llogaritje mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës (duke futur edhe koeficientin për muajt që kanë punuar gjyqtarët e larguar apo edhe gjyqtarët që filluan rishtas punë gjatë 2024), rezulton një numër mesatar prej **626** të çështjeve të reja për gjyqtar. Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën shumë të lartë në punë për gjyqtarët në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Shpërndarja e ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve në vitin 2024 është pothuaj e barabartë në numër çështjesh (duke mos u marr në konsideratë kompleksiteti i çështjeve).

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar në total **6883** çështje të reja dhe kanë përfunduar **5970** çështje.

Raporti mbi numrin i çështjeve për çdo gjyqtar (Case for Judge), llogaritur duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës;

$$\frac{6883 \text{ [totali i numrit të çështjeve të regjistruara]}}{11 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2024]}} = 626 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Ndërsa numri i çështjeve të gjykuara për çdo gjyqtar rezulton si më poshtë:

$$\frac{5970 \text{ [totali i numrit të çështjeve të gjykuara]}}{11 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2024]}} = 543 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Siç duket edhe nga përlllogaritjet e mësipërme, gjatë vitit 2024 çdo gjyqtar ka gjykuar mesatarisht **543** çështje, që gjithsesi është tregues shumë i lartë, por më i ulët se vlera e vitit 2023. Mendojmë që në këtë aspekt ka ndikuar fakti që gjyqtarët që filluan detyrën rishtaz, pavarësisht që ndikuan në rritjen e koeficientit të numrit të çështjeve për gjyqtar, u nevojitej kohë të njiheshin me dosjet që morën në ngarkim dhe të respektonin afatet për lajmërimin e palëve ndërgjyqëse. Ndërkohë, që gjyqtare Emirjana Dimo punoi vetëm **2 muaj**, pasi mori lejen e barrëlindjes, si rezultat ngarkesa që mori kjo gjyqtare u rishortuan tek gjyqtarët e tjerë, me vendim të Këshillit Të Gjykatës.

Ngarkesa e madhe e gjyqtarëve, ka ndikuar në një farë mase në tejkalimin e afatit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, megjithëse ka një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo ngarkesë ka sjellë gjithashtu vështirësi tek gjyqtarët për të programuar gjatë javës, ditë të caktuar për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, por shpresojmë që gjatë vitit 2025, mbase edhe me plotësimin e organikës me 5 magjistratë të tjerë, situata do të shkojë drejt normalizimit, duke bërë mundur rritjen e efikasitetit në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

a. Performanca për çdo gjyqtar

Gjatë vitit 2024, duke marrë shkak nga Vendimin e KLGJ-së për kriteret matëse të vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve, performanca e trupës gjyqsore në kuptimin sasior të përfundimit të çështjeve, paraqitet si në tabelën Nr.18. Në këtë aspekt, gjyqtarja Matilda Fetau për periudhën 9 mujore që ka punuar, ka mbuluar edhe detyrën e zv/kryetarit të gjykatës. Po kështu, duhet të përmendim faktin, që gjyqtarët që kanë punuar më pak se dy muaj, e kanë patur objektivisht të pamundur të arrinin parametrin, për arsyet që kemi përmendur me lart:

Tabela.18

Nr.	Gjyqtar:	Numri i çështjeve të përfunduara viti 2024	Koha që ka punuar në muaj	Rendimenti në përqindje krahasuar me standartin 429 çështje /vit
1	MATILDA FETAU	300	9	93%
2	IDUSH MALIQI	201	5	112%
3	ELIS DINE	566	12	132%
4	ARTUR PRENGA	642	12	150%
5	YRFET SHKRELI	607	12	141%
6	THOMAI DHA ROCA	236	7	94%
7	Ardit KUKA	804	12	187%
8	GJERGJI BACI	678	12	158%
9	AURORA ALIMADHI	567	12	132%
10	INA YZELLARI	550	12	128%
11	OLTA CENAJ	329	5	184%
12	SUELA LIKA	387	8	135%
13	EMIRJANA DIMO	10	1	28%
14	BOIKEN BENDO	46	1.5	86%
15	XHULIO DOKU	47	1.5	88%

b. Delegimet e gjyqtarëve:


Gjatë vitit 2024, asnjë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nuk ka qënë i deleguar për të gjykuar çështje në gjykata të tjera.

5. SHPEJTËSIA NË GJYKIM SIPAS KATEGORISË SË ÇËSHTJEVE.

Tabela.19

Kategoria e Çështjeve	ÇËSHTJE TË PËRFUNDUARA GJATË VITIT 2024			
	1-6 Muaj	7-12 Muaj	1-2 Vjet	> 2 Vjet
Civile të përgjithshme	45	70	121	92
Familjare	464	303	271	65
Kërkesa pa kundërshtarë	1063	293	60	22
TOTALI CIVILE	1572	666	452	179
Penale themeli (krime)	379	79	27	19
Penale themeli (kundervajtje)	73	27	14	14
Kërkesa administrative penale	2240	179	50	0
TOTALI PENALE	2692	285	91	33
TOTALI I ÇËSHTJEVE	4264	951	543	212

Raporti i shpejtësisë së gjyimit të çështjeve në total, penale dhe civile:



Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se **4264 çështje janë përfunduar së gjykuari brenda afatit 6 muaj**, **951 çështje janë përfunduar së gjykuari në harkun kohor 7-12 muaj**, **543 çështje janë përfunduar së gjykuari në harkun kohor 1-2 vjet** dhe **212 çështje janë përfunduar së gjykuari në afatin mbi 2 vjet**. Ka një rritje të çështjeve të përfunduar së gjykuari mbi 2 vjet, krahasuar me vitin 2023, ku ishin vetëm 75 çështje të tilla. Në fakt kjo tregon që me fillimin e punës, magistratët e rinj, po përfundojnë së gjykuari, çështje të vjetra, që në vitet e mëparshme nuk kishin gjetur zgjidhje për shkak të organikës së cunguar të gjykatës. Trupa e magistratëve, në mbledhjen e gjyqtarëve, ka hartuar një plan të veçantë për zgjidhjen e çështjeve të vjetra, që kanë një kohë

regjistrimi, mbi dy vite. Për këtë arsye nga ana e Këshillit të gjykatës është marrë vendim në Dhjetor 2024, për evidentimin e stokut (Back-log), të çështje mbi dy vjet, penale dhe civile, dhe adresimin e problematikave për këtë rast në KLGJ.

Më poshtë po paraqesim edhe raportet e shpejtësisë të gjykimit për çështjet:

Raporti i shpejtësisë së gjykimit të çështjeve penale:



Raporti i shpejtësisë së gjykimit të çështjeve civile:



Analizë mbi përmbushjen e standartave kohore ndërkombëtare

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm, arritjen e respektimit të afateve të gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”). Nga statistikatat e mësipërme rezulton se janë përmbushur plotësisht afatet e gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”).

Konkretisht 86.8 % e çështjeve **penale** nuk kanë zgjatur më shumë se 6 muaj; 96,1 % e çështjeve të gjykuara (krahasuar me standartin 90-95%) nuk kanë zgjatur më shumë se 12 muaj, dhe vetëm rreth 3.9% e çështjeve kanë zgjatur më shumë se 12 muaj. Por, nëse konsiderojmë vetëm çështjet penale themeli, rreth 11% e tyre kanë zgjatur më shumë se 12 muaj, dhe gjithsesi jemi afër standartit 90-95 % të çështjeve të zgjidhura brenda 12 muaj.

Gjithashtu përsa i përket çështjeve penale në gjykim (të papërfunduara), 19 % e tyre (krahasuar me standartin 5-10%) e kanë kaluar afatin 1 vit. Në këtë aspekt, konstatohet se kjo përqindje është gati dy herë më e lartë krahasuar me vitin paraardhës. Një shkak i shtuar në këtë drejtim është fakti i një numri shumë të lartë çështjesh që vitin e kaluar ishin afër kalimit të këtij afati. Kjo i dedikohet edhe largimit nga detyra të shumë gjyqtarëve gjatë këtyre tre viteve dhe kalimi i çështjeve të mbartura tek gjyqtarët e tjerë të mbetur në detyrë, duke rritur dukshëm ngarkesën.

Shkaqe të tjera për kohëzgjatjen e gjykimit mbi një vit, është pezullimi i gjykimit për të pandehurin në mungesë për kryerjen e kërkimeve të tjera me afat një vit dhe njoftimi i viktimës apo të pandehurit me letërporosi.

Nga të dhënat statistikore të 2024 për çështjet **civile** rezulton se kemi një rritje evidente të çështjeve të gjykuara pas afatit 12 muaj. Nëse vitin e kaluar kishim vetëm 11.6%. e çështjeve të gjykuara që kalonin afatin 12 muaj, këtë vit kjo vlerë shkon në 21.9 %. Në këto kushte, 79.1 % (krahasuar me standartin 90-95%) e çështjeve civile janë gjykuar brenda 12 muajve.

Nga krahasimi i disa prej të dhënave statistikore për vitin 2024 me standartet ndërkombëtare “Standardet Kohore të Dhomës Amerikane të Avokatisë” rezulton se: 35% (45. % në 2023) e **çështjeve civile** të përgjithshme (krahasuar me standartin 90%) janë gjykuar brenda 12 muajve, dhe 28.1 % (30.5% në 2023) e **çështjeve civile të përgjithshme** të gjykuara kanë kaluar afatin 24 muaj (referuar me standartin 100% të përfunduara brenda 24 muajve). Sasia e vogël e çështjeve të gjykuara brenda 12 muajve lidhet me faktin e përparësisë që trupa gjyqsore i ka dhënë gjykimit dhe përfundimit të çështjeve të trashëguar nga vitet e mëparshme, duke ulur stokun e tyre.

Përsa i përket çështjeve familjare, vetëm 42% (65 % në 2023) e tyre (krahasuar me standartin 98%) janë zgjidhur brenda 6 muajve dhe 70% (86% në 2023) (krahasuar me standartin 100%) brenda 1 viti. Duke analizuar të dhënat, gjejmë të përfunduara më shumë se rreth 450 çështje familjare ose gati 60% më shumë. Edhe në këtë rast, trupa gjyqsore i ka dhënë përparësi gjykimit të çështjeve të vjetra, për të reduktuar me sa mundet stokun e krijuar ndër vite, duke u zbatuar parimi i koherencës në regjistrim.

Çështjet penale për krime, 75.3% (80.9% në 2023) janë zgjidhur brenda 6 muajve (krahasuar me standartin 98%) dhe 90.9% (92.3% në 2023) brenda 1 viti (krahasuar me standartin 100%).

Mos arritja e standarteve edhe këtë vit, i dedikohet më së shumti akumulimit të problemeve që janë krijuar nga zvogëlimi vit pas viti i numrit të gjyqtarëve efektivë në gjykatë dhe përballimi i këtij numri të madh të çështjesh nga një grup i kufizuar gjyqtarësh. Këtë vit janë përfunduar

*rreth 1700 çështje më shumë se një vit më parë, por stoku i krijuar është ende i madh dhe do të duhet plotësimi sa më shpejt i organikës me 5 gjyqtarë të tjerë për përmirësimin e situatës. Mendojmë, që nëse vazhdohet më organikën aktuale, megjithë optimizmin tonë, do të duhen të paktën dy vite të tjera që të kapen standartet e kërkuara. **Ky standart përbën sfidën e gjykatës në kuptimin sasior të uljes së ngarkesës të çështjeve gjyqësore.***

Gjithashtu, gjykatës i mbetet objektivi i saj i brendshëm, dhënia e përparësisë në gjykim të çështjeve tejet komplekse, që kanë zgjatur më shumë se 18 muaj, me qëllim moskalimin e afatit 2 vjeçar të gjykimit, në respektim të jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Nga analiza e të dhënave, për **2869** çështjet civile të gjykuara, kanë zgjatur mbi 2 vjet vetëm **163** ose **5.6%** e totalit. Rezulton se numri është rritur krahasuar me **153** të tilla në 2023, por përqindja që ato zënë në totalin e çështje të gjykuara, është më e vogël. Shkaqet e tejkalimit të afatit 2-vjeçar janë kryesisht shkaqe ligjore që përjashtojnë përgjegjësinë për tejkalimin e afatit si:

- njoftimi i njërës prej palëve për gjykimin me letërporosi dhe kohëzgjatja për ekzekutimin e letërporosisë;
- pezullimi i gjykimit deri në zgjidhjen e një çështje tjetër gjyqësore, apo rastet e tjera të pezullimit të parashikuara në ligj;
- në gjykimet e pjestimit të pasurisë së paluajtshme mosvazhdimi i gjykimit në fazën e dytë të pjestimit deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për fazën e parë të pjestimit;
- shkaqe objektive për zëvendësimin e gjyqtarëve të çështjes si heqje dorë etj., dhe për rrjedhim rifillimi i gjykimit, njëkohësisht me njoftimet me shpallje për palët, si dhe ekspertime.

Por ndikim në këtë rezultat ka patur, siç e kemi theksuar më lart, edhe kalimi i çështjes në gjyqtarë të ndryshëm, si pasojë e largimeve të gjyqtarëve drejt gjykatave të tjera dhe ardhjes së gjyqtarëve të rinj.

Nga të dhënat statistikore e njëjta gjë mund të thuhet edhe për çështje penale. Rezulton se për **60** (nga 48 në 2023) është tejkaluar afati 2 vjet i gjykimit.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar në numër ditësh. Treguesi mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra që nënkupton kohën që duhet për përfundimin e një lloji çështjesh të caktuara në gjykatë, në dritën e ritmit të punës në atë gjykatë.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës **penale** është **291.31 ditë**.

$$DT_{\text{Penale 2024}} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2024}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2024}} = \frac{2475}{3101} \times 365 = \frac{2475}{3101} \times 365 = \mathbf{291.31}$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (case disposition time) për çështjet e natyrës civile është 352.53 ditë.

$$DT_{\text{Civile 2024}} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2024}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2024}} \times 365 = \frac{2771}{2869} \times 365 = 352.53$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (case disposition time) për të gjitha çështjet në total është 320.73 ditë.

$$DT_{2024} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2024}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2024}} \times 365 = \frac{5246}{5970} \times 365 = 320.73$$

Për të krahasuar të dhënat dhe për të kuptuar më mirë ecurinë, po bëjmë tabelën dhe grafikun e tendencës 5 vitet:

Tabela.20

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve penale				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
102.01	130.69	168.41	258.54	291.31





Tabela.21

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve civile				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
151.4	152.62	210.54	550.90	352.53




Të dhënat e mësipërme tregojnë mesatarizimin e kohëzgjatjes në ditë të gjykimeve për çështjet penale dhe civile.

Nga krahasimi me vitet paraardhëse, konstatohet një rritje e vazhdueshme e kohëzgjatjen mesatare të gjykimit të çështjeve **penale**, megjithëse këtë vit kjo rritje është vetëm 12 %, krahasuar me 53% që ishte një vit më parë.

Pozitive këtë vit është përmirësimi i këtij parametri për sa i përket çështjeve me natyrë **civile**. Kohëzgjatja mesatare e likuidimit të çështjeve në fund të 2024 paraqitet me një zvogëlim prej 36% krahasuar me vitin e kaluar, pra një ulje e ndjeshme.

Tabela.22

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin çështjeve në total				
Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
119.56	142.07	187.94	367.71	320.73



Duke ju referuar tre grafikëve të mësipërme, nxjerrim si konkluzion që përveç shtimit të ritmit nga seksioni penal, lind nevoja edhe për rritjen e numrit të gjyqtarëve në këtë seksion.

Edhe për totalin e çështjeve, në fund të vitit 2024, krahasuar me vitin paraardhës, rezulton se koha e nevojshme për likuidimin e të gjitha çështjeve, është reduktuar me 13%. Pavarësisht që shifra vazhdon të jetë në nivele të larta, kjo ulje na jep besimin që situata po ndryshon për mirë, duke synuar reduktimin e këtij parametri edhe për vitin 2025.

- Të dhënat e sistemit PAKS+ për vitin 2024, përsa i përket kohëzgjatjes së çështjeve të gjykuara, në ditë dhe në numër seancash:

Tabela.23

Tipet e çështjeve të gjykuara Viti 2024	Mesatarja nr. seancave nga depozitimi në vendim	Mesatarja në ditë nga depozitimi në vendim
Çështje Civile themeli	3.0	333.8
Çështje Penale themeli	2.8	178.6

Sipas të dhënave të sistemit, mesatarja e numrit të seancave prej **3.0** për çështje civile themeli është relativisht pozitive, pasi pavarësisht se ka një rritje krahasuar me vitin 2023, tregon për një qëndrueshmëri në këtë drejtim.

Për sa i përket mesatares së numrit të ditëve për çështje prej **333.8**, është një vlerë më e lartë se **282.5** e vitit të kaluar, por e pritshme duke patur parasysh ngarkesën e çdo gjyqtari, largimet dhe ardhjet e reja të gjyqtarëve dhe rishortimet e çështjeve në këtë kuadër. Pikërisht rishortimi, çon në rritjen e kohëzgjatjes së gjykimit dhe të seancave, pasi gjyqtari i ri, duhet të respektojë afatet e lajmërimit të palëve kur duhet të caktojë datat e reja për zhvillimin e seancave gjyqësore. Në fakt, duke filluar nga viti 2020, kohë kur ka filluar procesi i “Vetting” e deri në vitin 2024, kurba e mesatares së ditëve për zgjidhjen e çështjeve civile të themelit, gjykuar brenda vitit, është gjithmonë në rritje.

Konstatojmë që koha nga seanca në seancë është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme, gjë që ishte e pritshme për shkak të një numri më të madh të gjyqtarëve këtë vit, krahasuar me 2-3 vitet e mëparshme. Si rrjedhim, edhe ngarkesa për gjyqtar ka qënë më e vogël se e viteve të kaluara, duke krijuar më shumë mundësi për caktimin e datave të seancave.

Mesatarja e numrit të seancave për çështje penale themeli është **2.8**, pra një vlerë pak më e lartë se vlera **2.6** e këtij treguesi për vitin e kaluar. Mesatarja e numrit të ditëve për çështje, për vitin 2024 është **178.6**, pra ka rritje krahasuar me vlerën **123.7** të vitit 2023. Duhet theksuar se edhe trendi i këtij treguesi është gjithmonë në rritje. Arsyet e


rritjes se dy treguesve të mësipërm, janë të ngjashme me ato që u përmenden për çështjet civile të themëlit.

Një pengesë të konsiderueshme në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2024 përbën sistemi i shërbimit postar të njoftimeve, mungesa e një sistemi të saktë adresash, mungesa e njohurive procedurale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të Gjykatës. Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër etj. Në disa raste palët ndërgjygjëse hasin vështirësi për të siguruar dhe paraqitur provat e caktuara të cilat ndodhen pranë institucioneve shtetërore, dhe në disa raste vetë këto institucione përmbushin me vonesë urdhërat e gjykatës. Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që kanë ndikuar në shpejtësinë e gjykimit mbeten, sikurse në vitin e kaluar, ngarkesa e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës. Këto problematika kanë sjellë si domosdoshmëri një rol më aktiv të gjyqtarit për administrimin e procesit gjyqësor. Shkaqet e shtyrjes së seancave dhe zhvillimit të seancave joproduktive janë diskutuar rregullisht në të gjitha mbledhjet periodike me gjyqtarët me qëllim marrjen e masave për reduktimin e tyre.

Ne si staf, jemi besimplotë, që me shtimin e numrit të magistratëve, edhe këto tregues do të njohin një përmirësim të dukshëm gjatë vitit 2025.

6. KËRKESAT PËR HEQJE DORË:

Pranim	Mospranim	Totali
110	11	121



Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve edhe në vitin 2024 lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimarrje të mëparshme ku janë shprehur me vendim nga të cilat cënohet paanësia, kjo edhe për shkak të parashikimit në ligj të mosshqyrtimit të një çështje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër të caktuar. Pjesa tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.

7. PËRJASHTIMET E GJYQTARËVE NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE. **(Me kërkesë të palëve)**

Gjatë vitit 2024 janë pranuar 11 kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi i çështjeve. Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtim e gjyqtarëve, vërehet se, shkak kryesor i pranimit të kërkesës për përjashtim është garantimi edhe në dukje i paanshmërisë së gjyqtarit. Shkak i pushimit të kërkesave për përjashtim gjyqtari është shqyrtimi dhe pranimi i kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi. Ndërsa shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: paraqitja nga pala kërkuese si shkak përjashtimi vendimarrja e ndërmjetme e gjyqtarit, mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj, dhe mosdepozitimi i akteve për të provuar ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë.

Krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme rezulton se ka një ulje të konsiderueshme të numrit të kërkesave për përjashtim gjyqtari.

III. MENAXHIMI I LËVIZJES TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.

➤ Në vazhdimësi gjatë vitit 2024 ka patur bashkëpunim dhe mbështetje nga drejtuesi i Prokurorisë, Dhoma Vendore e Avokatisë, për implementimin e masave që lidheshin me reduktimin e kërkesave për shtyrje, konkretizimin dhe bazueshmërinë e tyre në prova, si dhe një planifikim më të mirë të gjykimit, kryerja e veprimeve procedurale brenda një afati të caktuar etj.

➤ Edhe me institucionet vendore si Komisariatet e Policisë Elbasan, Peqin. Gramsh, Librazhd dhe Cërrik, IEVP Elbasan, IEVP Peqin dhe IEVP Kosovë-Lushnje, Zyra Postare Elbasan, ka vazhduar bashkëpunimi për masat e ndërmarra në kuadër të planit të veprimit siç janë: paraqitja e dokumentave të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejtë me gjykatën edhe në rrugë elektronike, përmirësimi i mënyrës së kryerjes së njoftimeve, aplikimi i mënyrave alternative të njoftimit dhe komunikimit si p.sh me faks dhe rrugë elektronike.

➤ Gjykata ka aplikuar komunikimin elektronik me e-mail edhe me avokatët apo palë si dhe pjesëmarrës në proces si ekspertët, psikologët etj. si dhe ka përmirësuar përmbajtjen e njoftimeve me qëllim njoftimin në të njëjtën kohë të palëve edhe me të drejtat dhe detyrimet e tyre, si për t'u mbrojtur me avokat para se të fillojë procesi

gjyqësor, për të paraqitur prova etj. Po ashtu është kërkuar bashkëpunimi i të gjitha institucioneve vendore për komunikimin në rrugë zyrtare elektronike në një afat sa më të shpejtë nëpërmjet adresës elektronike zyrtare dhe bashkëpunimi me njësitë vendore dhe Bashkitë lidhur me përmirësimin dhe konfirmimin në kohë të njoftimit me shpallje.

➤ Nga ana e gjykatës janë organizuar një sërë takimesh si me përfaqësues të Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Dhomës Vendore të Avokatisë Elbasan, IEVP-të në juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan etj. Gjithashtu janë zhvilluar takime me punonjës të Zyrës Postare Elbasan, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit postar gjyqësor dhe zgjidhjes së problematikave të shtyrjes së seancave për arsye të moskthimit në kohë të përgjigjeve, apo parregullsive në njoftime.

2. Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS).

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan që prej vitit 2007 aplikohet sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS.

Edhe gjatë vitit 2024, në bazë të një kontrate që KLGJ ka lidhur me operatorin Kreatx është bërë e mundur suporti për problemet që janë paraqitur. Shërbimi nga ana e kompanisë Kreatx ka qenë korrekt dhe janë përgjigjur në kohë, për çdo kërkesë të bërë nga ana jonë si Gjykatë.

Po kështu, ka funksionuar normalisht edhe replikimi i të dhënave nga serveri i gjykatës në portalin e gjykatave, për një transparence më të madhe ndaj publikut. Vlen të theksohet se replikimi i të dhënave në portal, bën të mundur që përdoruesit e gjykatës të informohen në kohë reale për vijueshmërinë e çështjes ku janë palë ndërgjyqëse.

Në sistemin elektronik ka funksionuar rregullisht programi PAKS+ me qëllim planifikimin dhe raportimin e seancave gjyqësore sipas sallave të lira. Kushtet në gjykatë lejonë një punë normale në planifikimin e sallave të gjyqit, duke rritur ndjeshëm efikasitetin e punës dhe të kohës.

IV. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS:

Administrimi gjyqësor, i parë në frymën e ligjit 98/2016, kalon nëpër 3 hallka kryesore:

Burimet Njerëzore
Burimet Materiale
Burimet Financiare

Le të analizojmë më gjërë këto hallka dhe jo vetëm

1. Organika dhe burimet njerëzore.

Viti 2024 filloi me një organikë të gjykatës prej 11 gjyqtarë dhe 34 punonjës të administratës gjyqësore, nga të cilët 1 kancelar, 1 kryesekretare, 2 sekretare regjistruese, 13 sekretare gjyqësore, 1 specialist IT, 2 arkiviste, 1 K/D/Buxhetit, 1 specialisti Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, 1 magazinierë-arkëtare, 1 punonjës sigurie, 6 nënpunës gjyqësor, 2 sanitare, 1 shofer dhe 1 mirëmbajtës. Në fillim të vitit 2024 u shtua edhe 1 Specialist i Zyrës së Buxhetit si dhe 1 arkiviste dhe 1 sanitare, me kohë të pjesshme. Kontrata e arkivistes dhe sanitares është ndërprerë në fund të muajit Dhjetor 2024. Në përgjithësi, numri i punonjësve me status nëpunësi civil gjyqësor dhe me kontratë pune, i është përgjigjur nevojave të gjykatës, duke sjellë një zhdërvjellësi më të madhe në administrim dhe respektim të afateve dhe procedurave ligjore.

Vlen të përmendet, niveli i lartë i profesionalizmit i administratës që vjen si pasojë e përgjegjshmërisë dhe përvojës së gjatë në detyrë.

Në Zyrën e Kryesekretarisë është zhvilluar një volum i lartë pune në administrimin e lëvizjes së çështjeve gjyqësore, si fizikisht dhe elektronikisht. Marrja e masave shtesë, me 2 sek.regjistruese dhe 1 n/punëse gjyqësore në funksion të kësaj zyre, në drejtimin profesional të kryesekretares, ka mundësuar, përveç të tjerave dhe një shërbim gjyqësor eficient dhe të shpejtë si ndaj trupës gjyqësore, ashtu dhe përdoruesve të gjykatës. Me funksionim normal të zyrës të ZMP, fluksi i këtyre përdoruesve është diversifikuar dhe ka rezultuar një shpërndarje më e mirë e detyrave specifike.

Po kështu ftuesit gjyqësore, aktualisht 3 të tillë, kanë mbuluar një punë më të madhe dhe kohë më të shpejtë në komunikim. Mbetet sfidë në të ardhmen, ulja e shpenzimeve të njoftimeve me shërbimin postar, e cila do të shërbente në krahun tjetër në rritjen e tepricës së të ardhurave të gjykatës, të cilat janë të domosdoshme për plotësimin e nevojave tona. Fryma që duhet të përforcohet në gjithë administratën gjyqësore duhet të jetë ajo e të parit të Gjykatës si njësi ekonomiko-financiare autonome, autosuficiente dhe e përgjegjshme.

2. Këshilli i Gjykatës dhe Titullari.

Gjatë vitit 2024, Këshilli i Gjykatës ka funksionuar normalisht dhe në mbledhjet e këtij këshilli janë marrë **26** vendime në funksion të mbarvajtjes të punëve në gjykatë.

Po kështu, Zv/kryetari i gjykatës, ka marrë **11** vendime në cilësinë e titullarit, si dhe ka nxjerrë **30** urdhëra administrativë.

Gjatë vitit 2024, janë përgatitur dhe dërguar institucioneve të tjera **363** shkresa të natyrave të ndryshme.

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

Vendime Këshilli Gjykatës	26
Vendime të Zv/Kryetarit në cilësinë e titullarit	11
Urdhëra Administrativë nga Titullari	30
Shkresa dërguar institucioneve të tjera	363

3. Burimet materiale

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e ushtron veprimtarinë e saj në një godinë 4 kate +1 kat të nëndheshëm, ndërtuar në vitin 2017, dhe kërkon detyrimisht një menaxhim sa më mirë në mirëmbajtje. Të paturit e këtyre aktiveve qendrore të trupëzuara, në kuptimin financiar, sjell dhe një normë amortizimi të madhe në raport me shpenzimet. E gjithë kjo infrastrukture nuk mund të jetë efikase pa mirëmbajtje periodike dhe investime të reja pjesore. Me konkretisht, sistemi i kondicionimit, sistemet elektike, hidraulike, të ashensorit, sistemi për thirrjes së palëve dhe të sigurisë së mbrojtjes ndaj zjarrit, kërkojnë fonde monetare më të mëdha në dispozicion, në krahasim me gjykatat e tjera homologe të shkallëve të para. Në fakt, këtë vit konstatohet një përmirësim për sa i përket fondeve të vëna në dispozicion me qëllim mirëmbajtjen e sistemeve. Në këtë aspekt u modernizua sistemi për thirrjen e palëve ndërgjyqëse nga ana e sekretareve gjyqësore. Gjatë vitit 2024 filloi puna edhe për vendosjen e sistemit të ri të kondicionimit, falë një fondi të akorduar nga KLGJ për këtë qëllim.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka 10 salla gjykimi dhe një nga këto salla përdoret edhe për gjykimet online, po punohet aktualisht në vitin 2025 për krijimin e një sallë për gjykimet e të miturve.

Në lidhje me pajisjet e zyrave dhe të sallave, gjendja paraqitet shumë e mirë në standartin e përgjithshëm.

Edhe për sa i përket pajisjeve elektronike, këtë vit kemi patur furnizime të reja nga KLGJ të 6 PC për stafin dhe 4 printer, duke përmirësuar ndjeshëm situatën. Specialisti i IT, mban të përditësuara të gjitha sistemet elektronike të instaluar në gjykatë.

4. Teknologjia e informacionit.

Të gjithë gjyqtarët dhe administrata kanë në dispozicion pajisje të teknologjisë së informacionit që plotësojnë nevojat e punës në gjykatë. Në mënyrë periodike është bërë rifreskimi i këtyre pajisjeve. Të gjithë zyrat e gjyqtarëve, janë të pajisur përveç PC dhe printerave, edhe me skaner. Pajisja me këtë device ndihmon në punën e përditshme të gjyqtarëve, pasi kursen kohë dhe bën më të lehtë dërgimin elektronik të dokumentave zyrtarë në institucione të tjera, sidomos në IEVP-të, që janë në juridiksionin e Gjykatës sonë. Gjatë vitit 2024, siç e përmendëm më lart, gjykata u pajis me 6 kompjutera të rinj për gjyqtarët dhe administratën, si dhe me 4 printera.

Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar me sukses të plotë disa seanca video-konferenca me një gjykatë greke, si dhe lidhje me video konferencë me të dënuar nga IEVP Peqin. Kjo gjë, u arrit edhe nëpërmjet punës të sektorit të IT, duke plotësuar të gjitha kriteret e sigurisë.

Shorti elektronik: Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS mundëson përveç të tjerash ndarjen e çështjeve ndërmjet gjyqtarëve, me short elektronik. Kërkesat e vendimit Nr.554 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 29.12.2022 “PËR NDARJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE” janë respektuar në mënyrë rigoroze në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparencja e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit, duke u garantuar pjesëmarrja e publikut si dhe nëpërmjet publikimit të listës së shortit. Shorti i ditës, publikohet në faqen web të gjykatës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë përafërsisht të barabartë për të gjithë gjyqtarët. Diferencat justifikohen duke patur parasysh numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gadishmërisë së secilit gjyqtar, që mund të ketë qenë jo i barabartë. Për vitin 2024 janë kryer me sukses disa procese të rishortimit të çështjeve për gjyqtarët të cilët janë larguar dhe evidentualisht për të balancuar ngarkesën e përgjithshme të gjyqtarëve.

Për masat e sigurimit dhe kërkesat gjatë hetimeve paraprake, nga Kryetari e Gjykatës në zbatim të kompetencave ligjore është bërë sistematikisht planifikimi i gadishmërisë të gjyqtarëve sipas grafikut për shqyrtimin e çështjeve të natyrës urgjente, si rregull për një kohë një javore sipas rendit alfabetik duke marrë për bazë mbiemrin e gjyqtarit.

a. Sistemi i regjistrimit audio-video të seancave gjyqësore

Në muajin Shtator 2024 u vendos për herë të parë edhe regjistrimi video i seancave. Në saj të sistemit për regjistrimit audio-video të seancave (RDA), seancat gjyqësore në çdo rast janë zhvilluar në 10 sallat e gjyqit që ka gjykata dhe janë regjistruar audio-video. Në asnjë rast nuk është zhvilluar seancë gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve. Regjistrimi audio dhe video i seancave gjyqësore për vitin 2024 është 85.87% e seancave të zhvilluara, çka pasqyron qëndrueshmerinë e përdorimit të teknologjisë audio-video nga ana e gjykatës.

Përgjatë vitit nga ky rregull përbejnë rastet e seancave për shqyrtimin e kërkesave penale me karakter sekret, apo shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi, në të cilat nga gjykata nuk aplikohet përdorimi i sistemi RDA.

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

Raport për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio nga çdo gjyqtar në vitin 2024:

Tabela.24

Nr.	Gjyqtari	Seanca të regjistruara audio (SA)	Seanca të paregjistruara (SP)	Gjithsej(TOT)	Në % (SA/TOT*100)
1	MATILDA FETAU	945	18	963	98.13%
2	IDUSH MALIQI	287	12	299	95.99%
3	ELIS DINE	1963	34	1997	98.30%
4	THOMAI DHA ROÇA	784	605	1389	56.44%
5	YRFET SHKRELI	1242	79	1321	94.02%
6	ARTUR PRENGA	1820	99	1919	94.84%
7	INA YZELLARI	870	280	1150	75.65%
8	OLTA CENAJ	256	215	471	54.35%
9	AURORA ALIMADHI	1347	290	1637	82.28%
10	ARDIT KUKA	1628	336	1964	82.89%
11	GJERGJI BAÇI	1475	286	1761	83.76%
12	MEGI STRAKOSHA	1		1	100.00%
13	SUELA LIKA	1353	14	1367	98.98%
14	EMIRJANA DIMO	11	3	14	78.57%
15	BOIKEN BENDO	105	34	139	75.54%
16	XHULIO DOKU	64	23	87	73.56%
	Totali	14151	2328	16479	85.87%

Tashmë, të gjithë palët pjesmarrëse në një seancë gjyqësore, sa herë që kanë bërë kërkesë, janë pajisur me CD e regjistrimeve audio-video. Në faqen web të gjykatës është vendosur edhe suporti i duhur për përdoruesit e programit FTR, për të dëgjuar regjistrimet audio-video.

Zbatimi i këtij sistemi ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim.

Përdoruesit apo punonjësit janë udhëzuar për përdorimin e sistemit të regjistrimeve audio-video dhe kanë realizuar me sukses edhe transkriptimet e procesverbaleve të seancave edhe në rastet kur ai është kërkuar fjalë për fjalë, si dhe është zbatuar udhëzimi për procedurat e dhënies së kopjeve të regjistrimeve audio-video për përdorim nga publiku. Zbatimi i këtij sistemi ka treguar se është rritur ndjeshëm transparenca e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim, si për gjyqtarët dhe për palët e avokatët.

b. Programi i transparencës

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet pasqyrimit të tij në faqen zyrtare të gjykatës Elbasan, pranë portalit www.gjykata.gov.al.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.

Në raport me median, gjykata ka treguar bashkëpunim të vazhdueshëm, i cili rezulton se ka qënë në nivelin e duhur, duke komunikuar sipas rastit në lidhje me informacione apo seanca gjyqësore për të cilat publiku ka patur interes. Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve elektronike, si dhe në raste të tjera të veçanta më kërkesë të tyre është mundur prezencë në seancat gjyqësore publike duke mbajtur shënime apo dhe pamje filmike.

Rezulton se është kryer një punë e mirë për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të gjykatës në internet.

Në faqen zyrtare të gjykatës janë publikuar edhe video informuese për plotësimin e Formularit Elektronik të Aplikimit, orientimit në gjykatë, si të merret informacion mbi shortin dhe për kalendarin e seancave.

5. Ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.

Kryesekretaria dhe sekretaria gjyqësore janë funksionet që kanë qënë më shumë të ngarkuar. Vlen të theksohet ngarkesa shumë e lartë me çështje për secilin gjyqtar (mesatarisht 543 çështje të shqyrtuara për secilin) e numri total i seancave 16479 në vit dhe për rrjedhim ngarkesa e lartë në punë e secilës sekretare gjyqësore.

Rëndësi të veçantë i është kushtuar ofrimit të një shërbimi sa më të shpejtë dhe korrekt ndaj publikut.

Gjatë vitit 2024 numri i kërkesave për marrje të kopje të dokumentave arkivore apo informacioni arkivor të refuzuara, ka qënë jo shumë i madh.

Gjatë 2024 ka patur një numër të konsiderueshëm kërkesash për shërbim nga arkiva.

Problematikë vijon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për sistemin dhe inventarizimin e dosjeve arkivore në ambientet e arkivës. Për këtë

qëllim, janë përdorur edhe ambiente të tjera në gjykatë. Nga përvoja e vitit 2024, rezultoi që shtesa në organikë edhe me një specialiste me kohë të pjesshme ishte efikase, pasi u bë e mundur sistemimi dhe dërgimi pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Lundër, Tiranë të një numri të konsiderueshëm, prej rreth 5000 dosje. Për vitin 2025 ka nisur procedura për shtimin e organikës së arkivës së gjykatës edhe me një specialit me kohë të plotë.

6. Aksesit, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.

Me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi, është rritur numri i formularëve standart për kërkesa të ndryshme drejtuar gjykatës, Model Deklaratë Mbrojtje në procesin civil dhe akte të tjera të cilat ndihmojnë në veçanti palët e vetpërfaqësuar. Gjithashtu është arritur asistenca e personave me aftësi të kufizuar, përcaktimi i një ambienti të posaçëm për qëndrimin, publikimi i të drejtave dhe garancive. Gjykata ka siguruar akses fizik nëpërmjet rampave të personave me aftësi të kufizuar në lëvizje, në sallat e gjyqit. Edhe për vitin 2024, ky akses fizik garantohej për të 10 sallat dhe hyrjes në gjykatë. Gjithashtu gjykata ka pajisur mjediset e aksesit publik, K/Sekretarinë dhe për tek sallat e gjykimit me tregues për personat me shikim të kufizuar. Sfidë për të ardhmen mbetet sigurimi i asistencës së specializuar si interprete etj., nga organizata joqeveritare për personat me aftësi të kufizuar që marrin pjesë në procese apo marrin shërbim në gjykatë;

Në funksion të transparencës dhe me qëllim lehtësimin e procedurës së marrjes së informacionit nga palët e interesit për kalendarin e çështjeve të seancave gjyqësore të javës publikohen listat e gjykimeve të përditësuara çdo javë në faqen zyrtare në rubrikën Njoftime sipas relatorëve të çështjeve, lidhje e cila i njoftohet çdo të premtë publikut në rrjetin social facebook për aksesim të drejtëpërdrejtë si edhe njihjen dhe promovimin tek publiku me faqen zyrtare të gjykatave www.gjykata.gov.al

Janë hartuar dhe publikuar materiale informuese, të cilat më pas janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në rubrikën “Njoftime për publikun” ose Pasqyra e Shtypit, si edhe në rrjetet e saj sociale për të informuar grupet e interesit. Këto materiale informuese janë përshtatur me tematikat e përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit dhe referojnë informacion në lidhje me Organizimin e Pushtetit Gjyqësor, kompetencat e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shërbimet e ofruara gjykata, tarifat gjyqësore, materiale informuese në lidhje me përfitimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, plotësimin e formularit FEA. Mënyrat si palët ti drejtohen gjykatës për një kërkesë padi civile apo penale, materiale informuese mbi Instrumentet Ligjorë Ndërkombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, materiale informuese mbi mënyrat e kerkimit të informacion mbi shortin, kalendarin e seancave gjyqësore, trashëgimnë kulturore, të drejtat e fëmijëve, të miturit në konflikt me ligjin etj.,

Si kërkesë e ligjit për të Drejtën e Informimit dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, si edhe si pjesë e objektivave të Planit Strategjik të Komunikimit, jemi treguar rigoroz në trajtimin e kërkesë/ankesave të publikut që vijnë në adresë të postës elektronike dhe jo vetëm, nga palët në proces gjyqësor, publiku dhe mediat, duke zbatuar në mënyrë rigoroz legjislacionin në fuqi për të vlerësuar interesin e ligjshëm të palëve për marrjen e informacionit dhe për të mundësuar komunikimin e informacionit brenda afateve ligjore.

Në kuadër të afrimit të grupeve të interesit me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, gjatë kësaj periudhe të ushtrimit të funksionit dhe vendosjes në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit për periudhën kalendarike 2023-2024, jemi kujdesur të konceptojmë, organizojmë dhe përshtasim aktivitete me tematika të përcaktuara në objektivat e Planit të Veprimit, me qëllim informimin dhe afrimin e publikut, institucionet dhe grupet e interesit me veprimtarinë e gjykatës, aktivitete të cilat janë dokumentuar në rrjete sociale, faqen zyrtare të gjykatës dhe nëpërmjet Revistave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Organizimi i aktiviteteve të vazhdueshme është realizuar në përputhje me tematikat e përcaktuara në Planin Strategjik të Komunikimit, duke promovuar kështu një vullnet të mirë mes Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për afrimin e target grupeve të synuara, lehtësimin e aksesit në gjykatë dhe veprimtarinë e saj nga grupe interesi të caktuara, duke rritur kështu nivelin e besimit në publik.

Në kuadër të plotësimit të kërkesave të Planit Strategjik të Komunikimit, i cili është një plan me bazë objektivash, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nëpërmjet Kooridnatorit për të Drejtën e informimit, ka kryer në mënyrë të vazhdueshme përditësime në faqen zyrtare, këndet e informimit në Gjykatë dhe llogaritë e rrjeteve sociale me informacione të vazhdueshme në formë broshurash informuese ose video informuese, deklaratah për shtyp, publikime vendimesh me interes të lartë publik etj., nën kujdesin e vazhdueshëm të përzgjedhjes së materialeve, formave të trasmetimit dhe përzgjedhjes së tematikave nga Gjyqtari i Medias dhe Zv/Kryetarët e Gjykatës.

Është krijuar tradita e ndërveprimit me korrespondencë elektronike të përditëshme nga media, publiku, palët ndërgjyqëse, avokatët, institucione etj., të cilat ndërveprojnë nëpërmjet këtij mjeti për depozitim të shpejtë të kërkesave për shtyrje të seancave gjyqësore, për depozitim aktesh për seancat gjyqësore, për kërkesa përshpejtimi, kërkesa për informacion mbi çështjet në shqyrtim nga palët, informacione mbi statusin e gjykimit si edhe kërkesa të karakterit për informacione me karakter public, kërkesat e medias mbi raporte e statistika për gjykimet, si edhe me institucionet me të cilat ndërveprojmë për njoftimet e seancave gjyqësore në lidhje me kërksat për shoqërim të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Komisariatet e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan por dhe më gjërë. Korrespondencë e njoftimeve për seancat gjyqësore për Zyrat e Shërbimeve Sociale të Bashkive të Rrethit Elbasan, Institutin e Mjekësisë Ligjore, si edhe dërgimi i fletët-thirrjeve palëve në proces nëpërmjet postës elektronike zyrtare të gjykatës.

Përditësimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bëhet në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me publikimin e listave të çështjeve të gjykimit, shpalljeve publike, lajmërimeve përmes afishimit, njoftimeve për shtyp, publikimin e materialeve me informacion juridik mbi të drejtat e njeriut etj, duke ndihmuar kështu grupet e interesit për të patur një akses më të lehtë dhe më të thjeshtë në marrjen e informacionit për të cilin kanë interes.

7. Çështjet e infrastrukturës, ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.

Në vitin 2024 janë marrë masa për përmirësim në drejtim të sistemit të monitorimit të lëvizjeve në ambientet e brendshme të gjykatës. Gjithashtu janë marrë masa për monitorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar për mbrojtjen nga zjarri, përmbytjet dhe rreziqe të tjera. Po ashtu janë hartuar rregullat për garantimin e rendit dhe sigurisë në gjykatë.

Gjatë vitit 2024 kanë funksionuar normalisht 10 salla gjykimi, të pajisur me PC, mixer për regjistrimin audio, printer dhe monitorë TV (për rastet e seancave kur duhen të shfaqen video të dorëzuar si provë nga palët pjesmarrëse). Në çdo sallë u instaluan nga KLGJ edhe nga 2 kamera, që në muajin shtator 2024 u bënë funksionale edhe për regjistrimet video të seancave.

Kushteve e godinës së gjykatës garantojnë plotësisht elementët e sigurisë përsa i përket lëvizjes së veçantë të gjyqtarëve e të palëve. Po ashtu parkimi i gjykatës ka hapësirë të mjaftueshme për administratën gjyqësore dhe garantimin e sigurisë, pasi hyrja e parkimit është pajisur me qepen dhe me 4 kamera sigurie.

Pas problemit serioz me sistemin ngrohës-ftohës të godinës në fund të vitit 2023, në dhjetor 2024, pas fondeve që KLGJ akordojë për këtë qëllim, ka filluar puna për vendosjen e sistemit të ri. Sipas parashikimeve, në muajin mars 2025 sistemi i ri i ngrohje-ftohjen hyn në funksion të plotë.

Për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, hidraulik, ashensori etj, gjykata ka lidhur kontratë me operatorë të specializuar në këto fusha. Përsa i përket shërbimit të internetit, dhe mirëmbajtjes të sistemeve ICMIS apo RDA, kontratat me operatorët përkatës janë lidhur nga KLGJ.

8. Administrimi i fondeve publike për vitin 2024

Për vitin 2024 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka funksionuar me një nr. punonjësish, sipas listë pagesës prej 51 -54 punonjes në fund të vitit, nga të cilët janë paguar 16 gjyqtarë në fund të vitit 2024 (nga këta 3 të pezulluar nga KPK , , një leje lindje), 16 sekretare gjyqësore dhe 22 punonjës administrate. Për këtë nr. punonjësish është shpenzuar një fond page + sigurime = 127 620 mije lekë nga 128,808 mije lekë që ishte plani i buxhetit të shtetit për këto zëra, ose në përqindje realizuar 99%.

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

Për shpenzimet operative është çelur një fond nga buxheti i shtetit në vlerën 16 600 mijë lekë për vitin 2024, i cili është realizuar në masën 16 172 lekë, ose matur në % është realizuar 97%.

Përdorimi i këtij fondi është shpërndarë si më poshtë:

- 34.8 % e fondit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për shërbime të përgjithshme si energji, postë, ujë. respektivisht në vlerën 5 773 mijë lekë. Shërbimi postar, krahasuar me vitin 2023 është në rritje, për shkak se nr. i gjyqtarëve për kete vit ka qene me i larte se viti 2023.
- 15.4% e fondit është përdorur për shërbim avokatie, ekspert, psikolog, përkthyes, ose 2 557 mijë lekë. Këtu, duhet të mbahet në vëmendje, në lidhje me pagesën e eksperteve, nuk duhen paguar më tepër se 40 mijë leke **në zbatim të Udhëzimit Nr.4 datë 12.12.2012.**
- 27.1% e fondit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për materiale zyre si letër, tonera, kancelari, materiale pastrimi, shtypshkrime, botime 4 502 mijë leke.
- 11.3% shpenzime për mirëmbajtje të paisjeve elektronike, ashensori, cillera, godine, në vlerën 1 876 mijë lekë.
- 8.4% shpenzime të tjera, për karburant. pjesë këmbimi, siguracion, mirëmbajtje mjete transporti i gjykatës.
- Për investime është çelur një fond nga buxheti i shtetit në vlerën 15 118 mijë lekë për vitin 2024, i cili është realizuar në masën 10 733 mijë leke, ose e matur në përqindje është realizuar në masën 70.9% .

Përdorimi i këtij fondi është shpërndarë si më poshtë:

- 98.4% Rikonstrukcion i plotë i sistemit të kondicionimit ngrohje-ftohje.
- 1.6 % Blerje paisje elektronike.

Pasqyrimi i fondeve në total:

Tabela 25

Nr	mije leke			
	Përshkrimi i shpenzimit	Plani në lekë	Realizuar në lekë	Realizuar në përqindje
1	Shpenzime për personelin paga dhe sigurime shoqërore	127 620	128,808	99 %
2	Shpenzime operative	16 600	16 172	97%

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

3	Shpenzime për avokate nga të ardhurat e institucionit	258	258	100%
4	Shpenzime për mirembajtje nga të ardhurat e institucionit	118	118	100%

Pasqyrimi i realizimit të investimeve:

Tabela 26

Nr	mije leke			
	Përshkrimi i shpenzimit	Plani në lekë	Realizuar në lekë	Realizuar në përqindje
1	Investim për rikonstruksionin e sistemit të kondicionimit	14943	10558	70.6 %
4	Shpenzime për investime nga të ardhurat(Blerje paisje elektronike)	175	175	100%

9. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

➤ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës me qëllim plotësimin e kërkesave dhe marrjen e masave për trajtimin e ankesave, kryerjen e procesit të hartimit dhe administrimit të statistikave dhe ndjekjen e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore. Edhe në vitin 2024 gjyqtarët kanë ndjekur trajnimet vazhduese të organizuara kryesisht nga Shkolla e Magjistraturës.

➤ Në vitin 2023 janë zhvilluar disa takime formale dhe joformale dhe është rritur bashkëpunimi me institucionet si Prokuroria e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Komisariati i Policisë dhe Bashkia Elbasan, kryesisht për përmirësimin e procedurave që lidhen me plotësimin, paraqitjen dhe shqyrtimin e urdhërave të mbrojtjes, komunikimit sa më të shpejtë të vendimeve gjyqësore me qëllim zbatimin e menjëhershëm të tyre.

➤ Është bërë e mundur përfaqësimi i viktimave me avokat falas në rastet kur e kërkojnë. Kjo zyrë e vazhdon edhe aktualisht aktivitetin në Godinën e gjykatës, duke rritur aksesin e shtresave vulnerabel në drejtësi. Po ashtu, është ndjekur praktika e mëparshme për përcaktimin e listës së avokatëve kryesisht për periudhën e gadishmërisë, falë bashkëpunimit me Dhomën Vendore të Avokatisë Elbasan.

➤ Bashkëpunimi me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Dhomën e Avokatisë, Shërbimin Postar,

**RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR VITIN 2024**

Komisariatet e Policisë, IEVP në juridiksionin e gjykatës dhe institucione të tjera vendore, ka ndikuar pozitivisht në menaxhimin e qarkullimit të çështjeve gjyqësore. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka ndërmarrë inisiativën për realizimin e takimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme për marrjen e masave me qëllim rritjen e efektivitetit të drejtësisë, të lindur si nevojë nga ndryshimet në K.Pr.Civile dhe në K.Pr.Penale.

Një rëndësi të veçantë, gjykata i ka kushtuar edhe takimeve me nxënës maturante dhe studentë të Universitetit “A. Xhuvani.

Në përfundim, duke përfituar nga rasti, falenderimet u shkojnë të gjithë gjyqtarëve, sekretareve gjyqësore si dhe gjithë stafit të gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e një viti të ngarkuar dhe të vështirë për gjykatën tonë. Ju urojmë të gjithëve: Suksese për vitin 2025.

Elbasan, më 18.03.2025

Punoi:

- | | |
|-----------------|-----------------|
| • Artur Prenga | (Zv/Kryetar) |
| • Ledio Sulkuqi | (Kancelar) |
| • Ardian Pali | (Specialist IT) |

**ZV.KRYETAR I GJYKATËS
ARTUR PRENGA**